



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI QARKUT ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan _____._____.2024

VENDIM

Nr. _____ datë _____._____.2024

" PËR MIRATIMIN E RAPORTIT 4-MUJOR TË SHPENZIMEVE TË VITIT 2024"

Mbështetur në ligjin nr:139/2015" Për vetëqeverisjen vendore ", në ligjin.9936 datë. 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin nr. 10296 date 08.07.2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" në udhezimin e Ministrisë së Financave nr.22 datë 30.07.2018 "Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit" si dhe në Vendimin e Këshillit të Qarkut nr 12, datë 21.12.2023 "Për miratimin e planit të Buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm" Vendimit nr 04 dt 12.02.2024 "Për një ndryshim në planin e buxhetit të vitit 2024, Këshilli I Qarkut Elbasan, në mbledhjen e datës _____._____.2024

V E N D O S I:

1. Të miratojë Raportin e shpenzimeve Janar-Prill 2024 për programet:
 - a. Planifikim Manaxhim
 - b. Administrimi i Mbrojtjes se Tokes
 - c. Shërbimi Autik , Qendra Rezidenciale dhe Qendra sociale "Lulet e Diellit
2. Të miratojë Raportin e të Ardhurave Janar-Prill 2024
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit në Këshill.

KRYETAR

Ermira URUPI

Raporti i Monitorimit të zbatimit të buxhetit si 4 Mujor të Këshillit të Qarkut për vitin 2024

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2024 është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshtë:

- *Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*
- *Ligjin nr.68 /2017“Per financat e vetëqeverisjes vendore”*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008“ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.*
- *Udhëzimi i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018. “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar*
- *Udhëzimin plotësues të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.01 dt19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024“.*
- *Në Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 12 date 21.12.2023 “Për miratimin e planit të buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm”*
- *Në Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.04 date 12.02.2024 “Për një ndryshim në planin e buxhetit të vitit 2024”*

Misioni i Këshillit të Qarkut: Zhvillimi dhe zbatimi i politikave rajonale në Qarkun Elbasan në fushat ekonomike, turizmit, kulturës, shërbimit social, trashëgimise kulturore, mjedisit etj, harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore ne plotesim te funksioneve te veta ligjore si dhe cdo funksion tjetër I dhënë me ligj.

Objektivat kryesore për arritjen e misionit dhe përmbushjen e qëllimit të cdo sektori të Këshillit të Qarkut Elbasan

- Hartimi i strategjisë së zhvillimit për Qarkun e Elbasanit
- Koordinimi i aktiviteteve në të gjitha bashkitë e qarkut të Elbasanit për zbatimin e prioritetëve të Strategjisë Rajonale të zhvillimit për Qarkun e Elbasanit.
- Bashkëpunimi me të gjitha bashkitë në hartimin dhe zbatimin e Strategjive Lokale të zhvillimit.
- Nxitja dhe zhvillimi i turizmit duke bashkëpunuar me njesitë vendore e duke i dhënë akses të dorës së parë vetë bashkive në zbatim të strategjisë për zhvillimin e Turizmit.
- Promovimi i vlerave turistike të qarkut të Elbasanit nëpërmjet botimeve (guida turistike, kalendar festash, fletepalosje te ndryshme etj), pjesmarrje në panaire, aktivitete të ndryshme, etj.
- Koordinimi i punës me të gjitha bashkitë për hartimin dhe zbatimin e projekteve në fushën e arsimit në të gjithë Qarkun e Elbasanit.

- Bashkëpunim me organizata të ndryshme të shoqërisë civile për zhvillimin e projekteve mbi barazinë gjinore, dhunën në familje, moshën e tretë dhe ballkano-egjiptianet.
- Shtrirja e disa shërbimeve sociale në të gjithë territorin e qarkut në përputhje të plotë me nevojat dhe fuqizimin e kapaciteteve vendore në ofrimin e këtyre shërbimeve sociale dhe koordinimin e aktiviteteve për fëmijët.
- Rritja e nivelit të shërbimit në Qendrën e fëmijeve autik duke u përkujdesur për të gjithë fëmijët në nevojë të qarkut dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Gramsh.
- Rritja e identifikimit dhe ofrimit të asistencës së drejtperdrejtë për viktimat e trafikimit(fëmijë) në qarkun e Elbasanit.
- Hartimi i politikave për zhvillimin e vlerave kulturore e artistike të Qarkut dhe organizimi i aktiviteteve në kuadër të strategjisë rajonale.
- Permbushjen e funksionit të deleguar të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës duke i shërbyer komunitetit dhe përgjigjur në kohë kërkesave të Ministrisë por institucioneve të tjera.

Këshilli i Qarkut Elbasan gjatë 4 Mujsorit të vitit 2024 ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore me qëllim realizimin e funksioneve të tij dhe ato të deleguara në zbatim të kompetencave ligjore, Vendimeve të Keshillit të Qarkut Elbasan, planeve mujore duke synuar:

- Përdorimin me efektivitet të fondeve për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave ligjore
- Raportim dhe informim të sakte dhe në kohën e duhur për vendimarrjen me qëllim funksionin e duhur të institucionit

I. Menaxhimi i fondeve buxhetore për transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat

1. Realizimi dhe përdorimi me efektivitet i të ardhurave
2. Realizimi i shpenzimeve në përputhje me planet buxhetore.

II. Menaxhimi i fondeve të transfertës së kushtëzuar

1. Analiza e shpenzimeve të realizuara

MENAXHIMI I FONDEVE BUXHETORE

Këshilli i Qarkut Elbasan gjatë 4 mujorit të vitit 2024, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore me qëllim realizimin e funksioneve të tij dhe ato të deleguara sipas programeve të miratuara si më poshte:

- Planifikim Menaxhimi
- Administrimi i Mbrojtjes së Tokës
- Shërbimi Social

Buxheti i miratuar për vitin 2024 për Këshillin e Qarkut Elbasan për programin e Planifikim Menaxhimit është në vlerën 165318189.22 lekë i përbërë nga:

Transferta e pakushtëzuar viti 2024	77.755.109	lekë
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti 2023	71.543.080.22	lekë
Të ardhurat e planifikuara per vitin 2023	16,020,000	lekë
TOTAL	165.318.189.22	lekë
Drejtoria e Administrimit e Mbrojtjes së Tokës	9.488.000	lekë
Sherbimi Social	36.528.351	lekë

SHUMA 211,334,540.22 lekë

Burimet e financimit:

- Të ardhurat e vetë Institucionit
- Transferta e Pakushtëzuar
- Transferta e Kushtëzuar.

Funksionet kryesore te strukturave financiare:

- Për funksionet e veta
- Për funksionet e përbashketa
- Për funksionet e deleguara

Raporti monitorimit permban:

- Aneksi nr.1 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve”;
- Aneksi nr.2 “Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve”;
- Aneksi nr.3 “Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit”;

- Aneksi nr.4 “Raporti i realizimit të objektivave të programit”;
- Aneksi nr.5 “Raporti i investimeve me financim te brendshem”

Buxheti i Këshillit të Qarkut Elbasan funksionon me 3 programe buxhetore si më poshtë:

Nr	Llogaria/Programit	Emertimi i programit buxhetor
1	01110	Planifikim,menaxhimi dhe administrimi
2	01160	Administrimi i Mbrojtjes se Tokes
3	10430	Sherbimi Social

Buxheti ne funksion të Këshillit të Qarkut per vitit 2024 është në vlerë totale **211.334.539,22** sipas ndarjeve të mëposhtme

Planifikim Menaxhim	165,318,189.22	Leke
Administrim i Mbrojtjes se Tokes	9.488.000	Leke
Sherbimi Social	36.528.351	Leke

Për vitin 2024 fondet si 4- Mujor janë realizuar në shumën 53790 mijë leke në masën 43% sipas tabelës së mëposhtme

në 000/lekë

Programet	Emri	Buxheti 4/M 2024	Fakti 4/M 2024	Diferenca 4 M 2024	Realizimi ne %
Titulli					
01110	Planifikim Menaxhimi	110362	42575	67787	39%
01160	Administrim i Mbrojtjes se Tokes	3630	2543	1087	70%
10430	Sherbimi Social	12177	8672	3505	71%
Totali i shpenzimeve te institucionit		126169	53790	72379	43%

Fondet e planifikuara për tu përdorur nga Këshilli i Qarkut si 4 Mujor janë përdorur në vleren 42575 mije leke ne masen 39%; per DAMT jane perdorur 2543 mije leke ne masen 70 % dhe nga Sherbimet e Qendrave Sociale jane perdorur 8672 mije leke ne masen 71%.

SHPENZIMET E REALIZUARA SIPAS ZËRAVE PËR 4/Mujorin 2024 NGA ADMINISTRATA E KËSHILLIT TË QARKUT

Buxheti i periudhës 4 mujore për administratën e Këshillit të Qarkut është realizuar në nivelin 39% në vlerën 42575 mije leke nga 110362 mije leke të programuara.

Aneksi 2 Kodi I grupit 01110

në 000/lekë

Artikulli Kodi	Emri	Buxheti 4 M 2024	Fakti 4 M 2024	Diferenca 4 M 2024	Realizimi ne %
600	Paga	7250	5437	1813	75%
601	Sigurime Shoqerore	1200	908	292	76%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	9940	1933	8007	19%
604	Transferta korente te brendshme	57458	8530	48928	15%
605	Transferta korente te huaja	150	0	150	0%
606	Transf per buxhet fam dhe individ	40	0	40	0%
609	Fondi Rezerve dhe kontigjence	3000	0	3000	0%
Nentotali	Shpenzimet Korente	79038	16808	62230	21%
Nentotali	Shpenzimet kapitale	31324	25767	5557	82%
Totali	Korrente dhe kapitale	110362	42575	67787	39%

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqerore janë realizuar në zbatim të ligjit 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore dhe udhëzimit plotësues 6/3 datë 10.07.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor” për percaktimin e numrit të punonjësve të Këshillit të Qarkut “Për strukturën e administratës së Qarkut si dhe niveleve të miratuara të pagave me Vendim nr. 41 dt 21.12.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut, për vitin 2024 në mbështetje të VKM nr.177 date 08.03.2017 “ Për grupin e njesive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarev të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njesive të qeverisjes vendore”

Realizimi i llogarise se shpenzimeve te personelit per programin 1110 paraqitet si me poshte

në 000/lekë

Artikulli Kodi	Emri	Buxheti 4 M 2024	Fakti 4 M 2024	Diferenca 4 M 2024	Realizimi ne %
600	Paga	7250	5437	1813	75%
601	Sigurime Shoqerore	1200	908	292	76%
	Totali	20174	18048	2126	89%

Menaxhimi i buxhetit për këtë periudhë është bërë sipas programeve të miratuara në plan. Përdorimi i fondeve për shpenzime që ka patur në dispozicion administrata e Këshillit të Qarkut Elbasan rezulton si më poshtë:

I.Realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore për periudhën 4 mujore është kryer në zbatim të strukturës të miratuar nga Këshilli i Qarkut. Administrata përbëhet nga 13 punonjës të cilët paguhen me nivelin e pagave të miratuar me vendim të Këshillit të Qarkut (Vendim nr 24 date 21.12.2023). Fondi për paga dhe sigurime shoqërore është nga transfertat e pakushtëzuar e vitit 2024 .Për administratën e Këshillit të Qarkut realizimi i fondit për 4 Mujorin 2024 për llogarine 600 është në vlerën 5437 mije lekë dhe llogarine 601 ne vleren 908 mijë lekë perkatesisht në masën 75% dhe 76%

II.Për sa i përket shpenzimeve operative ato janë bërë duke permbushur nevojat dhe detyrimet për funksionimin normal të Administratës së Këshillit të Qarkut.

Theskojme faktin qe disa procedura per shpenzime operative jane ne proces, disa do te behen ne muajt ne vazhdim. Disa aktivitete te cilat nuk u realizuan kete 4-mujor jane lene per muajt ne vazhdim te vitit 2024

Projektet e investimeve me financim të brendshëm (artikulli 231)

Shpenzimet kapitale për periudhën 4 mujore janë realizuar në masën 25767 mije lekë nga 31324 mije lekë te celura për këtë artikull për periudhen 4 mujore të vitit 2024. (82 % realizim)

3.MENAXHIMI I FONDEVE TË TRANSFERTES SË KUSHTËZUAR

Këshilli i Qarkut Elbasan këtë vit është financuar nga transfertat e kushtëzuara për Shërbimin e Qendrës së Shërbimit Autik dhe fëmijë me aftësi të kufizuar, për Qendren Rezidenciale të fëmijevë të trafikuar dhe Qendrën ‘Lulet e Diellit’ dhe Drejtorinë e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës.

Realizimi i shpenzimeve vjetore i detajuar sipas qendrave është:

në 000/lekë

Artikulli kodi	Emri	Buxheti 4 mujor 2024	Fakti 4 mujor 2024	Diferenca 4 M 2024	Realizimi ne %
606	Transferte per individe qendra autike Elbasan	6080	4314	1766	71%
606	Transferte per individe qendra rezidenciale	4308	3056	1252	71%
606	Transferte per individe qendra lulet e diellit	1789	1302	487	73%
606	TOTALI	12177	8672	3505	71%

Me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi social Shtetëror fondi i akorduar për qendren e Shërbimit të Fëmijeve Autike për vitin 2024 është 18.239 mije lekë

Plan 4 mujor 6.080 mije leke dhe fakti 4314 mije leke, realizimi ne masen 71%

Për vitin 2024 fondi i akorduar për Qendren Rezidenciale të Fëmijeve të trafikuar eshte 12923 mije leke

Plani 4 mujor 4308 mije leke dhe fakti 3056 mije lekë realizuar në masën 71%

Për vitin 2024 fondi i akorduar për Qendrën Lulet e Diellit në Gramsh është 5366 mije lekë.

Plani 4 mujor 1789 mije lekë dhe fakti 1302 mije lekë realizuar në masën 73%

Pra si 12 mujor per te treja Qendrat: Plan 4 mujor eshte 12.177 mije leke dhe fakt 8672 mije lekë realizuar në masën 71%

DAMT

Realizimi i shpenzimeve për DAMT është si më poshtë:

në 000/lekë

Artikulli Kodi	Emri	Buxheti 4 mujor 2024	Fakti 4 mujor 2024	Diferenca 2024	Realizimi ne %
600	Paga	2950	2173	777	74%
601	Sigurime	550	363	187	66%
602	Mallra dhe sherbime	130	7	123	5%
Nentotal	Shpenzime korente	3630	2543	1087	70%

Në zerin 600-601 shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore nga 2950 mije lekë të planifikuara per vitin 4-mujorin e pare te vitit 2024 janë përdorur 2173 mije leke, në masën 74%

Në zërin 602 jane kryer pagesa per shpenzimet operative rutine si energji, telefon, uje etj per funksionimin e zyrave të saj nëpër rrethe në vlerën plan 130 mije leke dhe fakt 7 mije leke pra 5 %

1. Të ardhurat e arkëtuara ne periudhen Janar-Prill 2024

Llojet e të ardhurave që ka arketuar institucioni gjatë periudhës kanë qenë:

- Te ardhurat nga tarifat e ndryshme qe institucioni ka te percaktuar me akte ligjore dhe me vendim të Keshillit të Qarkut në funksion te sherbimeve qe ai i ofron komunitetit.
- Te ardhurat e trasheguara nga viti buxhetor 2024, të cilat jane planifikuar të përdoren për financimin e shpenzimeve te planifikuara per kete vit buxhetor.

Të ardhurat e realizuara nga Këshillit i Qarkut Elbasan janë ne vlerën 699 mijë lekë nga 16.020 mije lekë te planifikuara per vitin 2024.

në 000/lekë

	Emertimi	Plani 4/M 2024	Fakt 4/M 2024	% 4/M 2024
I	Te ardhurat TARIFAT	662	128	19%
	Zyra adm dhe mbrojtjes se tokes	500	128	26%
	Nga qerate e objekteve	162	0	0%
	Te ardhura te tjera jotatimore	20	0	0%
II	Kontributi i Bashkive	15338	502	3%
	Totali i te ardhurave	16020	630	4%

Të ardhurat e insitucionit janë realizuar në vlerën 630 mijë lekë. Nga këto 128 mije leke nga vertetimet e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, dhe 502 mije leke nga kontributet e Bashkive.

Theksojme faktin që këto të ardhura planifikohen në bazë të realizimeve të periudhave të mëparshme.

Realizimi i te ardhurave nga kontributi financiar i Bashkive është pak i vështirë pasi pak bashki kane bere derdhjen e kontributit të tyre për llogari të Qarkut .Disa Bashki kane ende detyrime të prapambetura të pa shlyera kundrejt Këshillit të Qarkut Elbasan.

KRYETAR

Ermira URUPI